



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.28

23 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.5, datë 2.3.2010	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.417, datë 18.04.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	875
Vendim i GJK nr.6, datë 4.3.2010	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	879
Vendim i GJK nr.7, datë 12.3.2010	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 4 të nenit 48 të ligjit nr.9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.10 047, datë 24.12.2008.....	882
Kërkesë e METE nr.1122/5, datë 3.3.2010	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore”, që preken nga ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400 KV, Tiranë 2 – Elbasan 2, qarkut Tiranë.....	889

VENDIM
Nr. 5, datë 2.3.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 27.10.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.21/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: KALOSH LAMOLLARI, përfaqësuar nga av.Avni Shehu dhe av.Brahim Lahi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Kujtim Luli, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.417, datë 18.04.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 31 dhe 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Berberi, përfaqësuesin e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e saj dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1204, datë 13.12.2005, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit Kalosh Lamollari, për kryerjen e veprës penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/2 i Kodit Penal (KP) dhe, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPrP), e ka dënuar përfundimisht me 3 vjet burgim dhe 4 000 000 (katër milionë) lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.218, datë 17.03.2006, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuarit.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs Prokuroria e Apelit Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.417, datë 18.04.2007, ka vendosur prishjen e vendimit nr.218, datë 17.03.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1204, datë 13.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më datë 24.06.2008, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë duke pretenduar se ky vendim është pasojë e një procesi të parregullt ligjor, për faktin se gjykatat në dhënien e vendimeve nuk kanë mbajtur parasysh rrethanat e ngjarjes dhe nuk kanë bërë vlerësimin e duhur të provave të administruara.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.102, datë 28.07.2008, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, për mungesë të shkaqeve që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

Më datë 6.4.2009, kërkuesi iu drejtua përsëri Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar një shkak të ri për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor për arsye se kjo gjykatë ka vepruar në kundërshtim me kompetencën e saj, duke pranuar për shqyrtim një rekurs të paraqitur tej afatit ligjor. Kërkuesi e mbështet pretendimin e tij në faktin se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, ndaj të cilit Prokuroria ka ushtruar rekurs, ka marrë formë të prerë më 17.03.2006, ndërkohë që rekursi në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë është depozituar më 18.04.2006, pra pas 33 ditësh. Në këto kushte ky rekurs nuk duhej të ishte marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, kërkoi rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar se vendimi i Kolegjit Penal është i mbështetur në ligj dhe nuk përmban elemente të procesit të parregullt ligjor, siç pretendohet nga kërkuesi. Sipas tij, rekursi i prokurorit kundër vendimit të gjykatës së apelit është paraqitur brenda afatit ligjor 30-ditor; rekursi mban datën 14.04.2006 dhe nga libri i dorëzimit të prokurorisë, ku është edhe vula e postës rezulton se praktika e rekursit është dorëzuar në postë po në këtë datë; sipas përlllogaritjeve, afati 30-ditor i paraqitjes së rekursit rezulton të ketë përfunduar më 16.04.2006, ditë e dielë dhe dita e parë e celebrimit të Pashkëve Katolike. Kjo ditë është festë zyrtare dhe sipas ligjit për festat zyrtare, kur dita e parë e festave zyrtare është e dielë, ditë pushimi do të jetë dita e hënë. Pra dita e hënë, datë 17.4.2006, ka qenë ditë pushimi zyrtar dhe dita e martë, datë 18.4.2006, ka qenë dita e parë pasardhëse e ditëve të pushimit dhe festës zyrtare.

II

Lidhur me pretendimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar rekursin e prokurorit të paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, si një nga aspektet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 19.06.2009; nr.10, datë 11.05.1006).

Kushtetuta, në nenin 43, parashikon se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, mbi bazën e parashikimit kushtetues, gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 6.03.2009; nr.14, datë 05.07.2005). Për këtë qëllim dispozitat procedurale parashikojnë si mjete ankimi apelin, rekursin në Gjykatën e Lartë dhe kërkesën për rishikim (neni 407 i Kodit të Procedurës Penale), duke parashikuar dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit.

Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së saj dhe asaj të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 19.06.2009; nr.26, datë 15.12.2008; nr.19, datë 23.12.2004). Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë ku konfliktet gjyqësore asnjëherë

nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë. (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.32, datë 2.12.2005).

Në bazë të nenit 141 të Kushtetutës “Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues”. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.13, datë 21.07.2008; nr.25, datë 30.07.2003). Por, Gjykata e Lartë nuk e ushtron këtë kontroll me iniciativën e saj. Ajo duhet të vihet në lëvizje nëpërmjet rekursit – si një nga mjetet e kundërshtimit që njeh procedura penale. Në rastin në shqyrtim, ajo është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të prokurorit, duke qenë se për kërkuesin ishte dhënë një vendim në favor të tij nga gjykata e apelit.

Bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë është organi që shqyrton në dhomë këshillimi, ndër të tjera, plotësimin e kushteve formale për paraqitjen e rekursit, pra nëse ai është bërë nga një person që legjitimohet, nëse janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit, si dhe nëse ai përmban shkaqe për t’u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kalimi i afatit ligjor e pengon gjykatën të marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore një recurs të paraqitur, sepse situata ligjore konsiderohet e zgjidhur përfundimisht dhe si e tillë ajo nuk mund të ndryshohet. Në rast të kundërt, siç u përmend më sipër, do të ishim përpara cenimit të parimit të sigurisë juridike.

Duke iu referuar çështjes në shqyrtim, kërkuesi pretendon se recursi i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës së apelit që kishte pushuar çështjen penale në ngarkim të tij është paraqitur jashtë afatit ligjor procedural dhe, në këto kushte, ai nuk duhej të merrej në shqyrtim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Gjykata ka vlerësuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është shprehur se për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve nga një “gjykatë” në respekt të nenit 6/1 të KEDNJ, është e domosdoshme që “gjykata” në fjalë të ketë juridiksion për të shqyrtuar të gjitha aspektet e faktit dhe të ligjit që kanë lidhje me çështjen përpara saj (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.06.2009).

Bazuar në materialet e dosjes gjyqësore në ngarkim të kërkuesit rezulton se vendimi i gjykatës së apelit, ndaj të cilit ka ushtruar recurs prokuroria, ka marrë formë të prerë më datë 17.03.2006 dhe u është komunikuar palëve në po këtë datë. Kodi i Procedurës Penale parashikon se recursi në Gjykatën e Lartë duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë (neni 435) dhe se në afatin e caktuar nuk llogaritet ora ose dita në të cilën fillon të ecë afati, por llogariten ora e fundit ose dita e fundit (neni 144/4). Pra, sipas kalendarit të zakonshëm, rezulton se afati për paraqitjen e rekursit përfundonte në datën 16.04.2006, ndërkohë që sipas dosjes gjyqësore, nga shënimi i sekretarisë gjyqësore në kopjen e rekursit, rezulton se ky recurs është paraqitur në gjykatën e shkallës së parë në datën 18.04.2006.

Subjekti i interesuar pretendon se recursi është paraqitur brenda afatit ligjor 30-ditor dhe e mbështet këtë pretendim në faktin se recursi dhe shkresa përcjellëse e prokurorisë mbajnë datën 14.04.2006, si edhe në faktin se libri i dorëzimit të prokurorisë, ku ndodhet edhe vula e postës, mban gjithashtu datën 14.04.2006. Sipas tij kjo është data e dorëzimit në postë të rekursit. Sipas nenit 413 të Kodit të Procedurës Penale, akti i ankimit paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimit, por ai mund të dërgohet gjithashtu me postë rekomande në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin dhe sekretaria shënon në zarf ditën e marrjes dhe e bashkëngjijt atë me aktet. Në këtë rast ankimi quhet i bërë në datën e dërgimit të aktit me postë rekomande.

Ligji e lidh afatin e fundit të depozitimit të ankimit me datën e paraqitjes në sekretarinë e gjykatës përkatëse ose me datën e dërgimit të tij me postë. Subjekti i interesuar nuk ka arritur të provojë përpara Gjykatës faktin e dërgimit të rekursit më datë 14.04.2006, pasi megjithëse ai ka paraqitur për këtë qëllim një fotokopje të fletës së librit të tij të dorëzimit të akteve, nuk ka paraqitur zarfin që e ka shoqëruar rekursin, ku në fakt duhet të ndodhej vula e postës që do të vërtetonte datën e saktë të dërgimit të aktit në gjykatë.

Megjithatë, sipas nenit 144/3 të Kodit të Procedurës Penale, afati i caktuar në ditë, kur mbaron në ditë pushimi ose feste, shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive. Sipas kalendarit të zakonshëm, data 16.04.2006 në të cilën përfundonte afati për paraqitjen e rekursit rezulton të ketë qenë ditë e dielë dhe gjithashtu dita e kremtimit të Pashkëve Katolike, çka provohet me shkresën nr.1052, datë 22.10.2009 të Komitetit Shtetëror për Kultet. Bazuar në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare”, dita e parë e Pashkëve Katolike është ditë pushimi dhe kur dita e festave zyrtare është ditë e dielë, dita e pushimit do të jetë dita e hënë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 144 të Kodit të Procedurës Penale, afati për paraqitjen e rekursit shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës, pra më datë 18.04.2006, datë në të cilën rezulton edhe të jetë depozituar në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se rekursi i prokurorit kundër vendimit të gjykatës së apelit është paraqitur brenda afatit ligjor, kurse pretendimi i kërkuesit rezulton i pambështetur në fakte e prova. Në këto kushte, Gjykata konkludon se nuk jemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, prandaj kërkesa duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza, Sokol Sadushi.

VENDIM
Nr.6, datë 4.3.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 22.12.2009 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr.33/20 Akti, që i përket:

KËRKUES: VERO HOXHA, përfaqësuar nga av.Xhemal Gazidede, me prokurë
SUBJEKTI I INTERESUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga znj.Erieta Cefa dhe Shamet Shabani, me autorizim.

ZYRA PËRMBARIMORE TIRANË, përfaqësuar nga z.Anastas Kote, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fehmi Abdiu; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që u shprehën për rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi Vero Hoxha ka qenë punonjës i administratës doganore. Me aktin administrativ nr. 786/8, datë 25.02.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është larguar nga puna. Komisioni i Shërbimit Civil me vendimin nr.81, datë 20.04.2005 ka vendosur “...shfuqizimin e aktit administrativ të largimit nga puna të kërkuesit si akt i nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji; kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, pagimin e pagës që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e këtij vendimi”.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 137, datë 16.12.2005 ka lënë në fuqi vendimin nr.81, datë 20.04.2005 të Komisioni të Shërbimit Civil. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.745, datë 31.05.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.137, datë 16.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë, Gjykata e Apelit Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit me vendimin nr. 23, datë 24.03.2006.

Në datën 28.12.2007 kërkuesi i është drejtuar zyrës së përmbarimit Tiranë, e cila po me këtë datë ka urdhëruar vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

Më pas DPD i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt kontaktimin e pavlefshmërisë absolute të titullit ekzekutiv, e cila, me vendimin nr.8885, datë 21.10.2008 ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për mosparaqitje të palës paditëse. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Në datën 18.04.2008, përmbauesi gjyqësor ka gjobitur Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave për nxjerrje pengesash për mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më 29.04.2008, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka kundërshtuar vendimin e përmbauesit për vënie gjobe.

Në datën 12.10.2009 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) dhe ka kërkuar konstatimin e cenimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak mosekzekutimit të vendimit nr. 137, datë 16.12. 2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas tij, mosekzekutimi i këtij vendimi i ka mohuar të drejtën për punësim në administratën publike. Po kështu, mosveprimi i organeve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, ka sjellë dhe shkelje të nenit 42 të Kushtetutës, duke mos i ofruar kërkuesit rivendosjen në vend të të drejtave kushtetuese nëpërmjet një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm.

Për sa më sipër, kërkuesi ka parashtruar para Gjykatës Kushtetuese kryesisht këto argumente:

- Zyra e përmbaimit nuk ka kërkuar forcërisht ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.137, konform kërkesave të nenit 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e përmbaimit gjyqësor”;

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e zvarrit qëllimisht ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe nuk është e vërtetë se ky vendim është në proces ekzekutimi sikundër ajo pretendon;

- Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë nuk kanë efekte prapavepruese edhe pse në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka theksuar se ato kanë fuqi prapavepruese;

- Nuk mund të pretendohet se urdhrat e ekzekutimit që kanë dalë para daljes së vendimeve unifikuese nuk mund të zbatohen, sepse kjo do të ndikonte në lëkundjen e besueshmërisë së qytetarëve të shteti për pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhënie të rregulluara që përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme;

- Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, por duhet të marrë masat e duhura për zbatimin e tyre;

- Argumenti që jep Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, se për të gjitha rastet analoge nuk është zbatuar vendimi gjyqësor për rikthimin në punë të ish-punonjësve nuk qëndron, sepse, sipas nenit 142/3 të Kushtetutës, të gjitha vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për ekzekutim nga organet e administratës publike;

- Vendimi nr.8993, datë 3.11.2009, për të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pretendon se është vendosur pavlefshmëria e vendimit nr.137, datë 16.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është një vendim antiligjor. Për këtë vendim nuk jemi vënë në dijeni.

Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka parashtruar se vendimi unifikues nr.8, datë 12.09.07 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka arritur në përfundimin se ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, nuk shtrihet mbi punonjësit e administratës doganore dhe se vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil që kanë shqyrtuar raste të kësaj natyre janë akte absolutisht të pavlefshme. Prandaj dhe për të gjitha rastet analoge si ai i kërkuesit Vero Hoxha nga DPD është mbajtur qëndrimi që të jepet dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar dhe jo të rikthehen në punë.

Arsyetimi i kërkuesit se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk po ekzekuton vendimin nuk qëndron, sepse ky institucion e ka vënë në procedurë ekzekutimi këtë vendim përse i përket dëmshpërblimit dhe është në kërkim të një vendi pune, pasi aktualisht në strukturën doganore nuk ka vende të lira pune.

Gjithashtu sipas DPD çështja është akoma në proces gjykimi, vendimi gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë, prandaj dhe kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti i interesuar, zyra përmbaimore Tiranë, ka parashtruar se ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në ushtrim të kompetencave dhetributeve që i jep ligji. Ligjvënësi, në asnjë normë juridike nuk parashikon një afat ligjor konkret, brenda të cilit duhet të ekzekutohet një titull 880

ekzekutiv, sepse duke vlerësuar vështirësitë dhe natyrën specifike të ekzekutimit të çdo titulli ekzekutiv përcaktimi i një afati të tillë bëhet i pamundur. Pra, afati i arsyeshëm mbetet subjektiv dhe pretendimi i kërkuarit për mosekzekutim të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm nuk qëndron.

Sa i përket pretendimit se zyra e përbarimit Tiranë nuk ka ekzekutuar forcërisht detyrimin, në kuptim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, përbaruesi gjyqësor ka aplikuar masën e gjobës, pra forcën shtrënguese që parashikon ligji procedural civil në rastet kur debitori nuk ekzekuton titullin ekzekutiv. Në rastin konkret, për kthimin në punë është i nevojshëm akti administrativ i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe, ekzekutimi i detyrueshëm nënkupton aplikimin e sanksionit të gjobës për të detyruar titullarin të nxjerrë aktin administrativ për kthimin në punë të kreditorit.

Zyra e përbarimit do të kryejë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme deri në ekzekutimin tërësisht të titullit ekzekutiv në fjalë.

II

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës është konsideruar si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, sepse vetëm pas realizimit të saj mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Në praktikën e saj të vazhdueshme, GJEDNJ e ka konsideruar pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur po këtë qëndrim në vendimmarrjen e saj dhe ka pranuar se: "...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në neni 142/3 të Kushtetutës nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj". Po ashtu, Gjykata ka theksuar se "Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre" (vendimi nr.43, datë 19.12.2007; vendimi nr.1, datë 19.01.2009, vendim nr.6, datë 6.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (vendimi nr. 27, datë 20.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese).

Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në çështjen "Qufaj kundër Shqipërisë", është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore që sipas sistemit juridik të brendshëm janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (vendimi nr. 1, datë 19.01.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua një fakt që nuk është evidentuar më parë. Pas përfundimit të këtij gjykimi dhe pas marrjes të vendimit formë të prerë, me vendimin unifikues nr.8, datë 12.09.2007, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin se ligji nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" nuk shtrihet mbi punonjësit e administratës doganore.

Më pas subjekti i interesuar, DPD ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuar me objekt, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të titullit ekzekutiv, vendimit nr.137, datë 16.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.81, datë 20.04.2005 të Komisionit të Shërbimit Civil; Marrjen e masës së sigurisë; Pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr.137, datë 16.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kjo gjykatë me vendimin nr.8993, datë 03.11.2009 ka vendosur pranimin e padisë; pavlefshmërinë absolute të titullit ekzekutiv, vendimit nr.137, datë 16.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr.81 datë 20.04.2005 të Komisionit Shërbimit Civil. Ky vendim nuk është apeluar nga kërkuar, para shqyrtimit të kësaj çështje nga Gjykata Kushtetuese.

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuar nuk ka shterur mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore. Sipas nenit 442 dhe 442/a të Kodit të Procedurës Civile kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit. Përderisa nuk është shfrytëzuar ky instrument juridik që ligji i ka lënë në dispozicion kërkuar për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore, çështja nuk mund të gjykohej dhe kërkesa për këtë shkak duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Fehmi Abdiu, Admir Thanza, Sokol Berberi

VENDIM

Nr.7, datë 12.3.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 26.05.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8/3 Akti, që i përket:

KËRKUES:DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË, përfaqësuar nga kryetari i saj Maksim Haxhia.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i pikës 4 të nenit 48 të ligjit nr.9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.10 047, datë 24.12.2008.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi; përfaqësuesin e kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë, që kërkuan rrëzimin e saj dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Në datën 17.07.2003, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9109 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon, në nenin 1 të tij, se: “Avokatia në Republikën e Shqipërisë është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar”.

Në datën 24.12.2008, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.10 047 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, me të cilin, midis të tjerave, në nenin 48 të ligjit 9109, u shtua pika 4 me këtë përmbajtje:

“Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përcaktojnë me vendim të përbashkët shpenzimet për regjistrimin e kandidatëve për avokatë, organizimin e provimit dhe shpalljen e rezultateve të tij, të cilat duhet të jenë të barabarta me koston që duhet të përballohet në këtë rast, si dhe tarifën e marrjes së licencës për avokatët.”

Kërkuari, Dhoma Kombëtare e Avokatisë (Dhoma ose DHKA), ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të dispozitës së mësipërme, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

Pika 4 e nenit 48 të ligjit të sipërcituar “Për profesionin e avokatit” vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë profesionin e avokatit; përcaktimi me ligj i tarifës së licencimit, shpenzimeve të regjistrimit të kandidatëve dhe organizimit të provimit përfaqëson shmangie nga parimet themelore të lirisë, pavarësisë dhe të vetërregullimit e vetëdrejtimit të Dhomës; bashkëpunimi i pretenduar midis Ministrisë dhe DHKA-së, i cili nuk ka aspak elementin marrëveshje dhe i formalizuar në vendimin e përbashkët ka si në formë edhe në përmbajtje elementin bllokues; nga vetë natyra e saj, tarifa e licencës nuk është taksë apo tatim, çka do legjitimonte pjesëmarrjen e Ministrisë të Drejtësisë si palë në vendimmarrje, lidhur me përcaktimin e masës së saj; organizimi i avokatisë si bashkim avokatësh dhe që funksionon e vetërregulluar e bën atë të ketë tiparet e një shoqate; në bazë të nenit 81/2 të Kushtetutës miratimi i ligjit të kundërshtuar kërkon një shumicë prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, sepse përbën devijim nga dispozitat e Kodit Civil.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

Kërkuari nuk legjitimohet të kërkojë antikushtetutshmërinë e normës duke paraqitur si argument vese në procedurën e miratimit parlamentar; kërkuarit i mungon çështja me interes kushtetues, pasi në thelb kërkohet analiza e pajtueshmërisë midis ligjeve, e cila nuk është detyrë e kësaj Gjykate; ligji nr.9109, i kundërshtuar, i përmbush të gjitha kërkesat e pavarësisë së avokatëve në aspektin kolektiv; Dhoma Kombëtare e Avokatisë është një organizim me prerogativa publike dhe

për këtë shkak kontrolli publik i caktuar me ligj është i nevojshëm; ndërhyrja e Ministrit të Drejtësisë në përcaktimin e tarifës së licencimit i shërben një qëllimi publik, atij të mbrojtjes së konkurrencës dhe rrëzimit të barrierave financiare të hyrjes në një profesion; Dhoma Kombëtare e Avokatisë është person juridik i krijuar me ligj dhe për rrjedhojë nuk është shoqatë, por një organizëm kolektiv i nevojshëm.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se:

Kërkuesi nuk argumenton se me cilin nen të Kushtetutës bie ndesh neni i kundërshtuar; DHKA nuk është institucion kushtetues; pavarësisht se neni 17 i ligjit i mundëson Dhomës, si person juridik, të ushtrojë veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti, ligji përcakton në mënyrë eksplicite një raport të caktuar të Dhomës me institucione të tjera; thelbi i dispozitës së kundërshtuar nuk qëndron në ndonjë rol bllokues që i jepet Ministrit të Drejtësisë, por në përcaktimin e disa rregullimeve ligjore, të cilat mundësojnë përmbushjen e një detyrimi publik dhe institucional që ka ky institucion sikurse është “reduktimi i barrierave që do të pengonin liberalizimin e tregut të shërbimeve ligjore”; dispozita e kundërshtuar nuk lejon që shteti apo Dhoma të sigurojë fitime nga shpenzimet dhe tarifa e licencës, gjë që do të krijonte një barrierë të pajustificuar për ata që zgjedhin të ushtrojnë profesionin e avokatit; pretendimi se ky ligj bie ndesh me dispozitat e Kodit Civil nuk qëndron, sepse Dhoma është një subjekt juridik i parashikuar me ligj të veçantë.

II

1. Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitetit të kërkuesit për të iniciuar gjykimin kushtetues.

Subjektet e interesuara kanë pretenduar se Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si jokushtetuese të dispozitës së kundërshtuar të ligjit “Për avokatinë”.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese rithekson se në një sërë vendimesh të saj janë interpretuar kriteret kushtetuese për legjitimitetin e subjekteve që mund ta vënë atë në lëvizje sipas nenit 134 të Kushtetutës (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.03.2008; nr.41, datë 16.11.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr.9, datë 26.02.2007). Bazuar në këtë dispozitë, dhe konkretisht në pikën 1, germa “f” të saj, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje, *inter alia*, me kërkesë të organizatave të tjera. Termi “organizata të tjera” është interpretuar se i referohet shoqatave, fondacioneve apo çdo organizimi tjetër, aktiviteti i të cilave mund të ketë qëllime politike, ekonomike, sociale, apo çdo qëllim tjetër të ligjshëm (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.07.2008; nr.16, datë 25.07.2008). Këto organizata e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Për pasojë, ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 28.04.2009).

Sipas ligjit nr.9109, Dhoma Kombëtare e Avokatisë është person juridik që ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur nga shteti. Dhoma përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 1 të statutit të saj, parashikohet se Dhoma është bashkim i anëtarëve aktivë dhe joaktivë të dhomave të avokatisë. Objekti i veprimtarisë së këtij subjekti është “Forcimi i pavarësisë së profesionit të lirë të avokatit; ... Mbrojta e avokatëve nga çdo qëndrim arbitrar ose presion që synon të cenojë pavarësinë e profesionit të avokatit” (neni 6 i Aktit të Themelimit dhe neni 2 i statutit).

Kërkesa, paraqitur Gjykatës Kushtetuese, përmban si argument për jokushtetueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, cenimin e parimeve themelore të lirisë, pavarësisë dhe të vetërregullimit e vetëdrejtimit të Dhomës. Nisur nga lidhja që ekziston ndërmjet objektit të veprimtarisë së Dhomës dhe çështjes së paraqitur për shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konkludon se Dhoma Kombëtare e Avokatisë legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj para Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1, germa “f”, dhe pika 2 të Kushtetutës.

III

1. Lidhur me pajtueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar me parimin e shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës)

Kërkuesi ka pretenduar se pika 4 e nenit 48 të ligjit të sipërcituar “Për profesionin e avokatit” vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë profesionin e avokatit, sepse kjo dispozitë përfaqëson një shmangie nga parimet themelore të lirisë, pavarësisë dhe të vetërregullimit e vetëdrejtimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita e kundërshtuar duhet të verifikohet në këndvështrim të respektimit të parimit të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës).

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese rithekson se parimi i shtetit të së drejtës është një nga parimet më themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike, përmbajtja e të cilit shfaqet në dispozita të ndryshme të Kushtetutës. Ky parim është një normë e pavarur kushtetuese, shkelja e të cilës përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 09.07.2009; nr.20, datë 11.07.2006; nr.34, datë 20.12.2005).

Gjykata Kushtetuese thekson gjithashtu, se nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës buron e drejta e kujtdo që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj (neni 42 i Kushtetutës); se kjo e drejtë nuk mund të kufizohet artificialisht dhe zbatimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të paarsyeshme; se e drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë apo institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 19.06.2009). Gjykata Kushtetuese përsërit se e drejta për një proces të rregullt ligjor lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi, në drejtim të respektimit të parimeve esenciale të procesit. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar si elemente përbërëse të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t’u dëgjuar. Këto dy të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, para marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht mbi thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t’u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 6.06.2005).

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se në procesin gjyqësor, individët nevojitet të ndihmohen efektivisht. Në këtë drejtim, avokatët luajnë një rol kyç për të siguruar që parimet e gjykimit të drejtë, të respektohen. E drejta e mbrojtjes merr një rëndësi të veçantë, sidomos në procesin penal. Kështu, gjatë këtij procesi kushdo ka të drejtë, të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij [neni 31, germa “c”, i Kushtetutës dhe neni 6, pika 3, germa “c”, i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)] dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 26.11.2009).

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, në një shoqëri demokratike, shërbimi i avokatisë luan një rol të rëndësishëm për të garantuar shtetin e së drejtës, si dhe për të siguruar një mbrojtje efikente të të drejtave të njeriut. Në një sërë dokumentesh ndërkombëtare vihet theksi në pavarësinë e avokatit nga shteti dhe në rëndësinë e vetërregullimit të këtij profesioni [shih Rekomandimin nr.R(2000) 21, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës; Parimet Themelore të Rolit të Avokatit, të miratuara nga Kongresi i Kombeve të Bashkuara në vitin 1990; si dhe Kartën e Parimeve Bazë të Profesionit Ligjor European, miratuar nga Këshilli i Dhomave të Avokatisë dhe Shoqërive Ligjore të Europës (CCBE)]. Për këto arsye, avokatia, si profesion i lirë dhe jo në varësi shtetërore, u nënshtrohet parimeve të integritetit moral, konfidencialitetit, respektit për rregullat e etikës, eliminimit të konfliktit të interesave, evitimit të veprimtarive të papajtueshme me ushtrimin e pavarur të detyrave të tyre, mbrojtjes së interesave të klientit dhe respektit për gjykatat.

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, në Rekomandimin nr.R(2000) 21 “Për lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit”, thekson, midis të tjerave, se duhen marrë të gjitha masat e nevojshme për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit pa

diskriminim dhe pa ndërhyrje të papërshtatshme nga autoritetet shtetërore; vendimet që kanë të bëjnë me autorizimin për të praktikuar si avokat ose për të hyrë në këtë profesion duhet të merren nga një organ i pavarur; dhomat e avokatisë ose shoqatat e tjera profesionale të avokatëve duhet të hartojnë standardet profesionale dhe kodet e etikës; dhomat e avokatisë dhe shoqatat e tjera profesionale duhet të jenë organe të vetërregulluara dhe të pavarura, të afta të përfaqësojnë interesat e avokatëve, të promovojnë edukimin dhe trajnimin e tyre të vazhdueshëm dhe të mbrojnë integritetin e tyre profesional.

Gjykata Kushtetuese thekson se pavarësia dhe autonomia e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, nga këndvështrimi i parimit të shtetit të së drejtës, ka vlerë kushtetuese. Parimet e përgjithshme të profesionit të avokatit, kërkojnë përcaktimin me ligj të garancive të nevojshme për qëllimin e ushtrimit të këtij aktiviteti. Administrimi autonom i avokatëve nga Dhoma, aspekt i së cilës është edhe autonomia financiare/buxhetore, njihet si garanci e aktivitetit të dhënies së ndihmës ligjore dhe është në pajtim me dispozitat kushtetuese. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese duhet të vlerësojë nëse rregullimi i ri i bërë nga neni 48 i ligjit nr.9109, është në pajtim me këto standarde.

Gjykata Kushtetuese vëren se ligji nr.9109 për avokatinë rregullon organizimin e profesionit të avokatisë, të drejtat dhe detyrat e avokatit, si dhe kushtet për ushtrimin e këtij profesioni. Sipas këtij ligji, profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë mund ta ushtrojë çdo shtetas shqiptar që plotëson kriteret e përmendura në këtë ligj. Dhoma, si një organizatë e pavarur dhe e paanshme, vendos për fitimin dhe mbarimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit dhe për regjistrimin dhe çregjistrimin nga regjistri i avokatëve, në bazë të kushteve dhe procedurave të përcaktuara në ligj.

Ligji për avokatinë (Ligji nr.9109) ka parashikuar një kontribut që duhet paguar si detyrim i anëtarësisë në dhomë – i cili, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, nuk barazohet me tarifën për licencimin – megjithatë, ligji nuk përmend një tarifë sa i përket dhënies së licencës për të ushtruar profesionin e avokatit. Kjo do të thotë se një juristi të diplomuar lejohet t'i jepet licenca e ushtrimit të profesionit të avokatit pas regjistrimit në regjistrin e Dhomës, pavarësisht nga detyrimi për pagimin e tarifës së regjistrimit. Në këto kushte Gjykata Kushtetuese vlerëson se pagesa e tarifës së regjistrimit nuk mund të trajtohet si një kërkesë shtesë për t'u bërë avokat që buron nga kushtet e përcaktuara nga ligji. Gjykata Kushtetuese vëren se ligji nr.9109 nuk parashikon tarifën e marrjes së licencës për avokatët dhe as organin që e përcakton atë, ndërkohë që statuti i Dhomës, miratuar në vitin 2005 nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë, në nenin 54 të tij parashikon se Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë përcakton shumën që duhet të paguajë avokati me rastin e marrjes së licensës që i jep atij titullin si të tillë. Duket se, me statutin e saj Dhoma ka tejkaluar kompetencat e dhëna nga ligji nr.9109 dhe ky tejkalim është reflektuar në miratimin e dispozitave që përcaktojnë pagesën e një tarife shtesë, të cilën i interesuari duhet ta përmbushë përpara marrjes së licencës për ushtrimin e aktivitetit.

Gjykata Kushtetuese konstaton se me ndryshimet e bëra në ligjin nr.9109, ligjvënësi ka konfirmuar vendosjen e një tarife për marrjen e licencës për të ushtruar aktivitetin, por duke parashikuar një vendimmarrje të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë sa i përket përcaktimit të shpenzimeve për regjistrimin e kandidatëve për avokatë, organizimin e provimit dhe shpalljen e rezultateve të tij, – të cilat duhet të jenë të barabarta me koston që duhet të përballohet në këtë rast – si dhe tarifës së marrjes së licencës për avokatët. Në këto kushte çështja që shtrohet për shqyrtim është nëse parashikimi në ligj i kësaj vendimmarrjeje të përbashkët të DHKA-së dhe Ministrit të Drejtësisë përbën ose jo cenim të pavarësisë dhe autonomisë së Dhomës.

Gjykata Kushtetuese thekson se shteti i ushtron funksionet e tij jo vetëm nëpërmjet një sistemi institucionesh shtetërore, por në një farë mase, edhe nëpërmjet organizimeve të tjera joshtetërore, të cilave u besohet me ligj, ushtrimi i funksioneve publike të caktuara. Pranohet universalisht se profesione të tilla, ndaj të cilave shteti ushtron një mbikëqyrje të kufizuar (jo vetëm profesionet ligjore), nënkuptojnë vetërregullimin e profesionit përkatës, vetërregullim që përfshin të gjithë profesionin dhe siguron, mes të tjerave, përfaqësimin e këtij profesioni në marrëdhëniet me shtetin dhe institucionet e vetërregulluara, si dhe në nivel ndërkombëtar, organizimin e trajnimit, përcaktimin e standardeve uniforme të etikës profesionale dhe kontrollin e respektimit të tyre, si dhe

kontrolle të tjera të aktivitetit të anëtarëve të profesionit përkatës, siç e kërkon ligji. Pa garantimin e një sistemi të tillë vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje, delegimi i funksioneve përkatëse në duart e individit privat do të ishte i pajustificueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në parim, ligjvënësit i lejohet të rregullojë profesionin e avokatit – për interes publik. Megjithatë, rregullimi – ndërhyrja – nuk duhet të cenojë autonominë e profesionit, aspekt i së cilës është edhe autonomia financiare/buxhetore. Nga kjo pikëpamje, rregullimi ligjor i kundërshtuar përbën një ndërhyrje të shtetit në profesionin e avokatisë. Rregullimi që bën neni 48 i kundërshtuar, ofron një vendimmarrje të përbashkët të DHKA-së dhe Ministrisë për të përcaktuar shpenzimet për regjistrimin e kandidatëve për avokatë, organizimin e provimit dhe shpalljen e rezultateve të tij, të cilat, sipas kësaj dispozite, duhet të jenë të barabarta me koston që duhet të përballohet në këtë rast, si dhe tarifën e marrjes së licencës për avokatët. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në një vendimmarrje të tillë të përbashkët, ekziston mundësia e bllokimit të veprimtarisë së Dhomës.

Subjektet e interesuara pretendojnë se qëllimi i këtij rregullimi ka qenë heqja e barrierave financiare të hyrjes në një profesion dhe garantimi i së drejtës kushtetuese për të fituar mjetet e jetesës nëpërmjet profesionit të zgjedhur lirisht. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson se ndërsa liberalizimi i profesioneve ligjore dhe aksesit i përmirësuar në shërbimin ligjor janë të dëshirueshme, ato duhet të kryhen me anë të zgjidhjeve që respektojnë dhe mbështeten në parimet që udhëheqin profesionet ligjore të kualifikuara si me cilësi të lartë dhe të përfshira në realizimin e një qëllimi publik, siç është profesioni i avokatit.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konkludon se përderisa autonomia e Dhomës nuk është e garantuar, rregullimi i kundërshtuar është jokushtetues.

2. Lidhur me pretendimin e shkeljes të së drejtës kushtetuese të organizimit kolektiv të individëve, parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës.

Kërkuesi ka pretenduar se pika 4 e nenit 48 cenon të drejtën e avokatëve për tu organizuar dhe për të funksionuar si shoqatë e pavarur jofitimprurëse.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në esencë, kërkuesi pretendon papajftueshmërinë e kësaj dispozite me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 11 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Neni 46 i Kushtetutës, ashtu si edhe neni 11 i KEDNJ-së, sanksionon të drejtën e organizimit kolektiv të individëve për çfarëdo qëllimi të ligjshëm, çka nënkupton se çdo person mund të bashkohet me të tjerë, me vullnet të lirë dhe pa ndërhyrjen e shtetit, për të arritur një qëllim të përbashkët të caktuar. Organizimet që hyjnë në fushën e veprimit të këtyre dispozitave karakterizohen nga “karakterit vullnetar”, gjë që nënkupton se një individ nuk mund të detyrohet të bëjë pjesë në shoqata. Por, Gjykata Kushtetuese thekson se jo të gjitha organizatat janë shoqata në kuptimin e dispozitave të mësipërme. Në kontekstin industrial ose profesional, liria e organizmit vullnetar në shoqata zbatohet vetëm për organizatat e së drejtës private. Shoqatat profesionale dhe të tjera që përcaktohen nga shteti dhe qeverisen nga e drejta publike, në parim, dalin jashtë fushës së veprimit të kësaj dispozite, pasi këto organizma janë pjesë e kuadrit rregullues dhe veprojnë në interesin publik për të siguruar ruajtjen e standardeve profesionale.

Gjykata Kushtetuese thekson gjithashtu se është ligjvënësi ai që vendos t’i japë një profesioni ligjor të caktuar statusin e profesionit dhe ta përcaktojë atë si një organizim të vetërregulluar. Është gjithashtu detyrë e ligjvënësit të zgjedhë modelin e aksesit në profesionin ligjor. Pra, krijimi i një profesioni dhe përzgjedhja e formës së tij organizative varet nga vullneti i ligjvënësit, formë e cila duhet të jetë sa më efektive e mundshme duke pasur parasysh qëllimet e këtij organizimi. Në rastin e profesionit ligjor (avokatisë), forma ligjore e organizimit duhet të kushtëzohet nga niveli i lartë i profesionalizimit, i cili, në shumicën e rasteve, shprehet në administrimin e drejtësisë dhe në detyrimin e shtetit, parashikuar në Kushtetutë, për të garantuar të drejtën e mbrojtjes. Realizimi i së drejtës së mbrojtjes përfshin jo vetëm të drejtën për të pasur një avokat, por dhe realizimin e një mbrojtje të kualifikuar dhe efektive. Pra, avokacia si profesion është e përfshirë në realizimin e një qëllimi publik, por në të njëjtën kohë Dhomë është një organizim i ndarë nga shteti dhe i ushtron funksionet në mënyrë të pavarur.

Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në një çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim, kur ka shqyrtuar statusin e Dhomës së Mjekëve në

Belgjikë (shih vendimin datë 23.06.1981, në çështjen *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgjikës*). Edhe Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut në vendimin e tij datë 2 korrik 1990 (kërkesa e paraqitur nga shoqata “Grupi i avokatëve të rinj” kundër Spanjës) ka theksuar se Dhoma e Avokatisë janë subjekte të së drejtës publike të rregulluara me ligj dhe ndjekin një objektiv në interesin e përgjithshëm, që është promovimi i pavarësisë dhe ndihmës ligjore të aftë, pra promovimi i vetë drejtësisë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese thekson se Dhoma Kombëtare e Avokatisë si organizim i avokatëve ka statusin ligjor të një subjekti të së drejtës publike, i themeluar nga ligjvënësi me qëllim që të përmbushë një funksion publik – kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit dhe mbrojtjen e autonomisë së këtij profesioni.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se një organ rregullues si Dhoma e Avokatisë nuk mund të konsiderohet si shoqatë në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës, sepse ky organizëm nuk është krijuar në ushtrim të së drejtës kushtetuese individuale të organizimit kolektiv. Përveç kësaj, fakti që ligjvënësi gëzon pushtetin të bëjë me ligj një rregullim të tillë, me anën e të cilit personat të cilët janë të angazhuar në një profesion të caktuar, duhet t’i përkasin *ex lege* një organizmi të caktuar që siguron vetëqeverisjen e këtij profesioni, nuk do të thotë se këta persona, nuk mund të bashkohen lirisht në shoqata të tjera të një karakteri (privat), apo të marrin pjesë në shoqata të tilla tashmë të krijuara, në ushtrim të së drejtës kushtetuese individuale të organizimit kolektiv. Gjykata Kushtetuese thekson gjithashtu se, megjithëse ligjvënësit i lejohet të themelojë organizime profesionale, këto organizime mund të formohen vetëm kur janë të nevojshme për qëllime publike që nuk mund të realizohen me mjete të tjera; sigurohet funksionimi demokratik e autonom i tyre; si dhe kur nuk pengojnë konkurrencën e lirë të shoqatave që kanë si qëllim mbrojtjen e interesave sektorialë në të njëjtën fushë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se dispozita e kundërshtuar nuk cenon të drejtën e organizimit kolektiv të avokatëve.

3. Lidhur me pajtueshmërinë e dispozitës së kundërshtuar me nenin 81/2 të Kushtetutës

Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu, se edhe nga pikëpamja e hierarkisë së ligjeve, në bazë të nenit 81/2 të Kushtetutës, miratimi i dispozitës së kundërshtuar do të kërkonte një shumicë prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, sepse përbën devijim nga dispozitat e Kodit Civil mbi shoqatat.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese sjell në vëmendje se në pjesën e mësipërme të këtij vendimi u konkludua se Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk është ngritur në ushtrim të së drejtës kushtetuese të organizimit kolektiv, parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës, por si një subjekt i të drejtës publike. Për pasojë, përderisa, në rastin në shqyrtim, nuk gjejmë zbatim dispozitat e Kodit Civil në lidhje me shoqatat e së drejtës private, pretendimi për nevojën e miratimit të ligjit të kundërshtuar me një shumicë prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 81/2 i Kushtetutës) është i papabuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 germa “a”, dhe nenit 134, pika 1, germa “f” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën dispozitën e pikës 4, të nenit 48 të ligjit nr.9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Pllaçi, Admir Thanja

Anëtar pjesërisht kundër: Kujtim Puto, Sokol Berberi, Vladimir Kristo (kryetar)

Anëtar kundër: Xhezair Zaganjori

KËRKESË
Nr.1122/5, datë 3.3.2010

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore”, që preken nga ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 400 KV, Tiranë 2 – Elbasan 2, qarkut Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është “Operatori i Sistemit të Trasmetimit” sh.a. Tiranë. Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të me poshtme.

Brenda 15-ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGETIKËS**
Dritan Prifti



OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH
LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2 - ELBASAN 2"
QARKU Tirane Komuna KASHAR

Objekti	LISTA E PRONAREVE PER SHPONESIM DEFINITIV (sip.banese, sip.shtylle)												
Numri i shtyllës	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji pasurise	Nr. kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m ² (totale)	Sip. banese m ²	Çmimi Banese ZRPP leke/ m ²	Sip shtylle m ²	Çmimi tokes leke/ m ²	Vlera e kompensimit leke	Shenime
2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Kashar													
1	Jakup	Ahmet	Sula	are	k-34-88-(231-C)	26/4/6	6300			89	415	36935	konfirm.zvrpp
2	Xhelal		Sorra	are	k-34-88-(231-C)	107/1/1	5000			96	415	39840	konfirm.zvrpp
3	Muhamet		Murati	are	k-34-88-(247-A)	190/6	25940			36	415	14940	nuk ka inform
prane 3	Jakup	Ramazan	Murati	banese	k-34-88-(231-C)	190/6		130	48800			6344000	konfirm.zvrpp
4	Qamil		Murati	are	k-34-88-(247-A)	186/5				47	415	19505	nuk ka inform
prane 4	Bari	Reshat	Sorra	banese	k-34-88-(247-A)	396		130	48800			6344000	nuk ka inform
5	Vezir		Sorra	are	k-34-88-(247-B)	422/7				47	415	19505	konfirm.zvrpp
6	Ismail	Ramazan	Sorra	are	k-34-88-(247-D)	456	1718			35	415	14525	konfirm.zvrpp
7	shtet			pyll	k-34-88-(247-D)	503				149			konfirm.zvrpp
8	shtet			pyll shkurre	k-34-88-(247-D)	503				137			konfirm.zvrpp
								260		350			
										636		12833250	
													SHUMA TOTALE



OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH
LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2 - ELBASAN 2"
QARKU Tirane Komuna PETRELE

Objekti	LISTA E PRONAREVE PER SHPONESIM DEFINITIV (sip.banese, sip.shtylle)													Shenime
Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m ² (totale)	Sip. banese m ²	Çmimi banese ZRPP leke/ m ²	Sip shtylle m ²	Çmimi i tokes leke/ m ²	Vlera e kompensimit leke		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
	Petrole													
	41	Eqerem	Nuredin	Pareshi	are	2947	5/2/19	3000			84	269	22596	certifikate
1	42	Hafuz		Dizdari	livadh	K-34-100-(59-B)	424/5				58	269	15602	nuk ka inform
2	43	shtet			are	K-34-100-(59-B)	5/1/09				44			konfirmuar
	Mullet													
3	44	shtet			pyllpishe	K-34-100-(60-A)	290/5				61			nuk ka inform
4	45	shtet			pyllpishe	K-34-100-(60-A)	290/5				64			nuk ka inform
5	46	shteti			pyll livadh	K-34-100-(60-A)	290/5				55			nuk ka inform
6	47	shtet			shkurre	K-34-100-(60-A)	150				85			nuk ka inform
7	48	shtet			shkurre	K-34-100-(60-B)	137				51			nuk ka inform
8	48 A	shtet			shkurre	K-34-100-(60-B)	307/1				55			nuk ka inform
9	49	Ershef	Ramazan	Teqja	livadh	K-34-100-(60-B)	218/30				51	233	11883	certifikate
10	51	Ramazan		Haxhiu	livadh	K-34-100-(60-B)	231/1				71	233	16543	certifikate
11	52	Zydi		Teqja	ullinj	K-34-100-	252/3,				100	233	23300	certifikate

						(61-A)								
	Fikas													
12	53	Haki	Islam	Kerciku	pyll shkurre	K-34-100-(61-A)	765				121	317	38357	nuk ka inform
	mes 53-54	Zeqine		Bakalli	banese	K-34-100-(61-A)	22/16		150	36600			5490000	nuk ka inform
13	54	Bedri		Bakalli	are	K-34-100-(61-A)	22/3				55	317	17435	nuk ka inform
14	55	Sefer		Danga	are	K-34-100-(61-B)	35/5				58	317	18386	nuk ka inform
	afer 55	Sefer		Danga	magazine	K-34-100-(61-B)	35/5		100	54900			5490000	nuk ka inform
	Qeha - shytaj													
15	56	Selman	Mustafa	Sula	are	K-34-100-(61-B)	45/24				64	265	16960	nuk ka inform
16	57	Mustafa		Hasmeta	pemetore	K-34-100-(61-D)	131/1	1100			85	265	22525	konfirmuar
17	58	Daut		Kupi	are	K-34-100-(62-C)	173/13				47	265	12455	nuk ka inform
18	59	Arben	Sherif	Sinani	are	K-34-100-(62-C)	190/4	6900			36	265	9540	konfirmuar
19	60	Arben	Sherif	Sinani	are	K-34-100-(62-C)	301/17				66	265	17490	nuk ka inform
20	61	Enver	Bajram	Sinani	are	K-34-100-(78-A)	520/9,520/8				102	265	27030	nuk ka inform
21	62	shtet			ullinj	K-34-100-(78-B)					69			nuk ka inform
22	63	shtet			pyll shkurre	K-34-100-(78-B)	370				36			nuk ka inform
									250		998			
										SHUMA TOTALE	1518		11250102	



OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH
LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2 - ELBASAN 2"
QARKU Tirane Komuna Berzhite

Objekti		LISTA E PRONAREVE PER SHPONESIM DEFINITIV (sip.banese, sip.shtylle)												Shenime
Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m ² (totale)	Sip. banese m ²	Çmimi Banese ZRPP leke/m ²	Sip shtylle m ²	Çmimi i tokes leke/m ²	Vlera e kompensimit leke		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	64	shtet			pyll pishe	K-34-100-(78-B)					58			nuk ka info
	Ibe e poshtme													
2	65	Gani	Vesel	Kaça	are	K-34-100-(78-B)	88	3500			74	258	19092	konfirm vrpp
3	66	Hysni	Osman	Tuzi	are	K-34-100-(78-D)	84/1	1000			128	258	33024	nuk ka info
	mes 66-67	Gani	Vesel	Kaça	banese	k-34-100-(79-C)	88	5751	462	36600			16909200	nuk ka info
	mes 66-67	Neki	Shyqyri	Cenaliu	banese 2k	k-34-100-(79-C)	220/1	1425	253	36600			9259800	nuk ka info
4	67	Neki	Shyqyri	Cenaliu	are	K-34-100-(78-C)	220/1	1300			128	258	33024	nuk ka info
5	68	shtet			pyll shkure	K-34-100-(78-C)	370				46			nuk ka info
									715		330			
									SHUMA TOTALE		434		26254140	



OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH
LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2 - ELBASAN 2"
QARKU Tirane Komuna Krrabe

Objekti		LISTA E PRONAREVE PER SHPONESIM DEFINITIV (sip.banese, sip.shtylle)												Shenime
Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m ² (totale)	Sip. banese m ²	Çmimi banese ZRPP leke/ m ²	Sip shtylle m ²	Çmimi tokes leke/ m ²	Vlera e kompensimit leke		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
	Mushqeta													
1	69	Hysen	Selim	Velija	are	K-34-100-(95-A)	"4/1/9				58	254	14732	nuk ka inform
2	70	Mynyr	Idriz	Shehu	are	K-34-100-(95-A)	45/14	4620			94	254	23876	konfirm.zvrpp
3	71	shteti			pyll shkure	K-34-100-(95-B)	169				93			nuk ka inform
4	72	shteti			pyll shkure	K-34-100-(95-D)					103			nuk ka inform
	Skutere													
5	73	Rapush	Riza	Saliu	are	K-34-100-(96-C)	142				86	203	17458	nuk ka inform
6	74	shteti			are	K-34-100-(96-C)	127				63			nuk ka inform
7	75	Illir		Basha	are	K-34-100-(96-C)	150				37	203	7511	nuk ka inform
											275			
									SHUMA TOTALE		534		63577	



OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT/DPZH
LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES ELEKTRIKE 400 KV "TIRANA 2 - ELBASAN 2"
QARKU Tirane Komuna Vaqarr

Objekti		LISTA E PRONAREVE PER SHPONESIM DEFINITIV (sip.banese, sip.shtylle)												Shenime
Numri i shtylles	Emri	Atesia	Mbiemri	Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Prona ne m ² (totale)	Sip. banese m ²	Çmimi banese ZRPP leke/m ²	Sip shtylle m ²	Çmimi i tokes leke/m ²	Vlera e kompensimit leke		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
	Allgjate													
1	9	Bashkim		Kusi	are	1017	19/1	37550			47	493	23171	perdorus
2	10	Myrteza	Murat	Allgjata	are	1017	16/6	4000			64	493	31552	pa certifikat
3	11	Mustafa	Latif	Allgjata	pyll shkure		128/3	80			44	63	2772	nuk ka inform
4	12	Hajdar		Allgjata	pyll shkure		128/12				89	63	5607	nuk ka inform
5	13	Seit	Haxhi	Shima	pyll	3064	30/nje	1613400			89	63	5569.2	nuk ka inform
6	14	shtet			pyll	3064	Y 30				117			nuk ka inform
7	15	shtet			pyll	3064	30				112			nuk ka inform
	Lalm													
8	16	shtet			pyll pishe	k-34-100-(24-C)					86			nuk ka inform
	pas 16	Zef	Pal	Prenga	zdrukhtari	k-34-100-(24-C)	2		220	54900			12078000	nuk ka inform
9	17	Qamil	Myslym	Uku	are	k-34-100-(24-C)	1				36	320	11520	nuk ka inform
	17	Xhevdet	Hamit	Bardhi	are	k-34-100-(24-C)					36	320	11520	nuk ka inform
	Vaqarr													
10	18	shtet			livadh	k-34-100-(40-A)					117			nuk ka inform
	Domj-fort													

11	19	shtet			lum	k-34-100-(40-A)	11	1000			58			nuk ka inform
12	21	shtet			livadh	k-34-100-(40-B)	7				70			nuk ka inform
	mes 21-22	Petrit		Tresa	banese	k-34-100-(40-B)			100	36600			3660000	nuk ka inform
13	22	shtet			livadh	k-34-100-(40-B)	7				35			nuk ka inform
14	23	shtet			pyll	k-34-100-(40-B)	4				56			nuk ka inform
15	24	Ferhat	Myslým	Sultafa	are	k-34-100-(41-A)	1				64	542	34688	nuk ka inform
16	25	Familja		Tresa	are	1441	20/8/9/10				64	542	34688	pa certifikate
17	26	Ymer		Damjani	are	1441	20/25				64	542	34688	nuk ka inform
	mes 26-27	Gjergj		Angjeli	stalle kuajsh,vend roje	k-34-100-(41-C)	19/5,	te vleresohet objekti	80	36600			2928000	konfirmuar
18	27	Gazmend		Hasani	are	1441	13/22				68	542	36856	konfirmuar
	Bultice													
19	28	Gezim		Lamaj	are	1315	41/3	6900			68	387	26316	konfirmuar
20	29	Fatmir		Lamaj	are	1315	41/18				55	387	21285	
21	30	shtet				1315	91				61			konfirmuar
	mes 30-31	Flamur	Agron	Xhabafti	lokal 1996	k-34-100-(41-D)	93		180	54900			9882000	nuk ka inform
22	31	shtet			pyll shkurre	1032	nje				96			konfirmuar
	Arbane													
23	32	Gani		Gjata	are	1032	4/4(kater)	6640			113	531	60003	konfirmuar
24	33	Shaqir		Balla	are	1032	gjashte/2	4720			68	531	36108	konfirmuar
25	34	Shaqir		Balla	are	1032	tete/tre	5600			58	531	30798	konfirmuar
26	35	Isuf	Xhemal	Allamani	are	3784	6				85	531	45135	pretendues
27	36	Isuf	Xhemal	Allamani	are	3784	4/22,4/23				61	531	32391	pretendues
	Vishaj													
28	37	Naim	Mustafa	Aga	are	3784	13/13				61	423	25803	nuk ka inform
29	38	Shpetim	Misar	Aga	are	3784	9				71	423	30033	nuk ka inform
30	39	Zija	Xhemal	Hidri	are	3784	47				74	423	31302	nuk ka inform

	mes 38-39	Ibrahim		Aga	banese 1k	k-34-100- (59-A)	47	Vit 2003	32	36600			1171200	nuk ka inform
	afer 40	Bujar	Fadil	Dumi	banese 1k	k-34-100- (59-A)	49	vit 2005	110	36600			4026000	nuk ka inform
31	40	Sadik	Fadil	Dumi	are	3784	1				64	423	27072	nuk ka inform
									722		1443			
								SHUMA TOTALE			2251		34344077.2	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 19.3.2010

Doli nga shtypi më 23.3.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë